

Përkthim jozyrtar i bërë nga Qendra Shqiptare për të Drejtën Ndërkombëtare (ACIL), mbështetur nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (Fondacioni IRZ).



ALBANIAN CENTER
OF
INTERNATIONAL LAW

DEUTSCHE STIFTUNG FÜR
INTERNATIONALE RECHTLICHE
ZUSAMMENARBEIT E.V.



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Gefördert durch Deutschland
Stability Pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany

01.

STATUTI I KONFERENCËS SË HAGËS MBI TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE *E miratuar më 31 tetor 1951 Ndryshuar më 30 qershor 2005*

Qeveritë e vendeve të përmendura më poshtë:

Republikës Federale të Gjermanisë, Austrisë, Belgjikës, Danimarkës, Spanjës, Finlandës, Francës, Italisë, Japonisë, Luksemburgut, Norvegjisë, Hollandës, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë dhe Zvicrës;

Duke pasur parasysh karakterin e përhershëm të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private;

Duke dëshiruar të theksojnë këtë karakter;

Duke shprehur, për këtë qëllim, dëshirën për ta pajisur Konferencën me një Statut;

Kanë rënë dakord për nenet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi i Konferencës së Hagës është të punojë për njehsimin progresiv të rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 2

1. Anëtarët e Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private janë shtetet, të cilët kanë marrë pjesë tashmë në një ose më shumë sesione të Konferencës dhe që kanë pranuar Statutin ekzistues.

2. Çdo shtet, pjesëmarrja e të cilit, nga pikëpamja juridike, është e rëndësishme për veprimtarinë e Konferencës, mund të bëhet anëtar. Pranimi i anëtarëve të rinj do të vendoset nga qeveritë e shteteve pjesëmarrëse, nëpërmjet propozimit të njërit, ose disa prej tyre, me anë të një shumice votash, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur ky propozim iu është paraqitur qeverive.

3. Pranimi do të bëhet përfundimtar nëpërmjet pranimit të këtij Statuti nga shteti i interesuar.

Neni 3

1. Shtetet anëtare të Konferencës mund të vendosin, gjithashtu, në një takim që lidhet me çështjet dhe politikën e përgjithshme ku është e pranishme shumica e shteteve anëtare, me anë të shumicës së votave të hedhura, pranimin si anëtare çdo Organizatë Rajonale të Integritimit Ekonomik, e cila ka paraqitur një kërkesë për anëtarësim tek Sekretari i Përgjithshëm. Referimet tek anëtarët në bazë të këtij Statuti duhet të përfshijnë organizatat anëtare, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe. Pranimi do të bëhet efektiv me pranimin e Statutit nga Organizata Rajonale e Integritimit Ekonomik në fjalë.

2. Për të pasur të drejtën për të aplikuar për anëtarësim në Konferencë, një Organizatë Rajonale e Integritit Ekonomik duhet të jetë e përbërë vetëm nga shtetet sovraane, dhe në të cilën shtetet e saj anëtare kanë transferuar kompetencën lidhur me një sërë çështjesh brenda kompetencës së Konferencës, duke përfshirë autoritetin për të marrë vendime të detyrueshme për shtetet anëtare të saj në lidhje me këto çështje.
3. Çdo Organizatë Rajonale e Integritit Ekonomik që aplikon për anëtarësim, në kohën e këtij aplikimi, do të paraqesë një deklaram të kompetencave duke specifikuar çështjet për të cilat kompetenca i është transferuar asaj nga shtetet anëtare të saj.
4. Çdo organizatë anëtare dhe shtetet e saj anëtare do të garantojnë që çdo ndryshim në lidhje me kompetencën e organizatës anëtare ose në anëtarësinë e saj do t'i njoftohet të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do ta qarkullojë këtë informacion për anëtarët e tjerë të Konferencës.
5. Shtete anëtare të organizatës anëtar do të supozohet që të ruajnë kompetencën mbi të gjitha çështjet që lidhen me transferimet e kompetencave që nuk janë deklaruar ose njoftuar specifikisht.
6. Çdo anëtar i Konferencës së mund t'i kërkojë organizatës anëtare dhe shteteve të saj anëtare që të japin informacion nëse organizata anëtare ka kompetencë në lidhje me ndonjë çështje specifike që është parashtruar Konferencës. Organizata anëtare dhe shtetet e saj anëtare do të garantojnë që ky informacion është dhënë pas një kërkesë të tillë.
7. Organizata anëtare do të ushtrojë të drejtat e anëtarësimit në një mënyrë alternative me shtetet anëtare të saj që janë anëtare të Konferencës, në fushat e kompetencave të tyre përkatëse.
8. Organizata anëtare mund të ushtrojë mbi çështjet brenda kompetencave të saj, në çdo mbledhje të Konferencës në të cilën ka të drejtën që të marrë pjesë, një numër votash të barabartë me numrin e shteteve anëtare të saj, të cilët i kanë transferuar kompetencën organizatës anëtare për sa i përket çështjes në fjalë, dhe të cilët kanë të drejtë të votojnë dhe janë regjistruar për takime të tilla. Kurdo që organizata anëtare ushtron të drejtën e saj për të votuar, shtetet anëtare të saj nuk do të ushtrojnë të drejtën e tyre dhe anasjelltas.
9. "Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik" nënkupton një organizatë ndërkombëtare që përbëhet vetëm nga shtetet sovraane dhe tek e cila shtetet e saj anëtare kanë transferuar kompetencën lidhur me një sërë çështjesh, duke përfshirë autoritetin për të marrë vendime të detyrueshme për shtetet anëtare të saj në lidhje me këto çështje.

Neni 4

1. Këshilli mbi Çështjet dhe Politikën e Përgjithshme (më poshtë "Këshilli"), i përbërë nga të gjithë vendet anëtare, është i ngarkuar me detyrën e vënies në funksionim të Konferencës. Takimet e Këshillit, në parim, do të mbahen çdo vit.
2. Ky Këshill e siguron funksionimin nëpërmjet Byrosë së Përhershme, aktivitetet e së cilës ai drejton.
3. Këshilli do të shqyrtojë të gjitha propozimet që kanë për synim të vendosen në rendin e ditës së Konferencës. Ai do të jetë i lirë të përcaktojë veprimet që do të ndërmerren lidhur me këto propozime.
4. Komiteti i Përhershëm Qeveritar i Hollandës, i krijuar nga Dekreti Mbretëror i datës 20 shkurt 1897 me synimin për të nxitur kodifikimin e së drejtës ndërkombëtare private, pas konsultimeve me anëtarët e Konferencës, do të përcaktojë datën e sesioneve diplomatike.
5. Komiteti i Përhershëm Qeveritar do t'i drejtohet vetë Qeverisë së Hollandës për thirrjen e anëtarëve. Kryetari i Komitetit të Përhershëm Qeveritar kryeson sesionet e Konferencës.
6. Sesionet e zakonshme të Konferencës, parimisht, do të mbahet çdo katër vjet.

7. Nëse është e nevojshme, Këshilli, pas konsultimit me Komitetin e Përhershëm Qeveritar, mund t'i kërkojë Qeverisë së Hollandës të thërrasë Konferencën në sesion të jashtëzakonshëm.

8. Këshilli mund të konsultohet me Komitetin e Përhershëm Qeveritar për çdo çështje tjetër që ka të bëjë me Konferencën.

Neni 5

1. Byroja e Përhershme do të ketë selinë e saj në Hagë. Ajo do të përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe katër sekretarë, të cilët do të emërohen nga Qeveria e Hollandës nëpërmjet prezantimit nga Komiteti i Përhershëm Qeveritar.

2. Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretarët duhet të zotërojnë njohuri ligjore të përshtatshme dhe eksperiencë praktike. Në emërimin e tyre do të merret parasysh, gjithashtu, diversiteti i përfaqësimit gjeografik dhe ekspertiza ligjore.

3. Numri i sekretarëve mund të rritet pas konsultimeve me Këshillin dhe në përputhje me nenin 10.

Neni 6

Nën drejtimin e Këshillit, Byroja e Përhershme do të ngarkohet me:

a. përgatitjen dhe organizimin e sesioneve të Konferencës së Hagës dhe takimeve të Këshillit dhe çdo Komisioni të Posaçëm;

b. punën e sekretariatit të sesioneve dhe takimeve të pasqyruara më sipër;

c. të gjitha detyrat që janë të përfshira në aktivitetin e një sekretariati.

Neni 7

1. Me qëllimin për të lehtësuar komunikimin ndërmjet anëtarëve të Konferencës dhe Byrosë së Përhershme, Qeveria e çdo shteti anëtar do të përcaktojë një organ kombëtar dhe çdo organizatë anëtare një organ kontakti.

2. Byroja e Përhershme mund të komunikojë me të gjithë organet e përcaktuara në këtë mënyrë dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente.

Neni 8

1. Sesionet dhe, në intervalet ndërmjet sesioneve, Këshilli, mund të krijojnë Komisione të Posaçme për të përgatitur projekte konventash, ose për të shqyrtuar të gjitha çështjet e së drejtës ndërkombëtare private që dalin në përputhje me qëllimin e Konferencës.

2. Sesionet, Këshilli dhe Komisionet e Posaçme, në masën më të madhe të mundshme, do të funksionojnë në bazë të konsensusit.

Neni 9

1. Shpenzimet e buxhetit të Konferencës do të ndahen ndërmjet shteteve anëtare të Konferencës.

2. Një organizatë anëtare nuk do t'i kërkojë të kontribuojë përveç shteteve anëtare të saj në buxhetin vjetor të Konferencës, por do të paguajë një shumë që do të përcaktohet nga Konferenca, në konsultim me organizatën anëtare, që të mbulojë shpenzimet shtesë administrative që lindin nga anëtarësia e saj.

3. Në çdo rast, shpenzimet e udhëtimit dhe jetesës të delegatëve të Këshillit dhe Komisionet e Posaçme do të jenë të pagueshme nga anëtarët e përfaqësuar.

Neni 10

1. Buxheti i Konferencës do t'i paraqitet çdo vit Këshillit të Përfaqësuesve Diplomatikë të shteteve anëtare në Hagë për miratim.
2. Këta përfaqësues do të ndajnë, gjithashtu, ndërmjet shteteve anëtare, shpenzimet që janë përcaktuar në këtë buxhet për këto shtete.
3. Përfaqësuesit diplomatikë do të takohen për këto çështje nën drejtimin e Ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës.

Neni 11

1. Shpenzimet që rezultojnë nga sesioni i rregullt i dhe i jashtëzakonshëm i Konferencës do të mbulohen nga Qeveria e Hollandës.
2. Në çdo rast, shpenzimet e udhëtimit dhe jetesës së delegatëve do të mbulohen nga anëtarët respektivë.

Neni 12

Veprimtaria e Konferencës do të vazhdojë të vëzhgohet nga të gjitha pikëpamjet, me përjashtim kur kjo është në kundërshtim me këtë Statut ose me Rregulloret.

Neni 13

1. Amendamentet e këtij Statuti duhet të miratohen me konsensusin e shteteve anëtare të pranishëm në një takim në lidhje me çështjet dhe politikën e përgjithshme.
2. Këto të hyjnë në fuqi, për të gjithë anëtarët, tre muaj pas miratimit të tyre nga dy të tretat e shteteve anëtare në përputhje me procedurat e tyre të brendshme respektive, por jo më herët se nëntë muaj nga data e miratimit të tyre.
3. Takimi i referuar në paragrafin 1 mund të ndryshojë me konsensus periudhat kohore të referuara në paragrafin 2.

Neni 14

Për të siguruar zbatimin e tyre, dispozitat e këtij Statuti do të plotësohen nga rregulloret. Rregulloret do të hartohen nga Byroja e Përherhme dhe do t'u paraqiten për miratim një sesioni diplomatik, Këshillit të Përfaqësuesve Diplomatikë ose Këshillit për Çështjet dhe Politikën e Përgjithshme.

Neni 15

1. Ky Statut do t'u paraqitet për miratim qeverive të shteteve që kanë marrë pjesë në një ose më shumë sesione të Konferencës. Ai do të hyjë në fuqi sapo të pranohet nga shumica e shteteve të përfaqësuara në sesionin e shtatë.
2. Deklarata e pranimi do të depozitohet pranë qeverisë së Hollandës, e cila do t'ua bëjë të njohur qeverive që përmenden në paragrafin e parë të këtij neni.
3. Qeveria e Hollandës, në rastin e pranimi të një anëtari të ri, do të informojë të gjithë anëtarët për deklaratën e pranimi të atij anëtari të ri.

Neni 16

1. Çdo shtet anëtar mund të denoncojë këtë Statut pas një periudhe prej pesë vjetësh, pas hyrjes së tij në fuqi, sipas termave të nenit 15, paragrafi 1.
2. Njoftimi i denoncimit do t'i jepet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Hollandës, të paktën gjashtë muaj para mbarimit të vitit buxhetor të Konferencës dhe do të veprojë në fund të këtij viti, por vetëm për atë shtet, i cili ka njoftuar për një gjë të tillë.

Tekstet në anglisht dhe frëngjisht të këtij Statuti, të amenduara më 1 janar 2007, janë njësoj autentikë.